



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:070577

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06525771

A.nr.616 /2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni dhe me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Nikolla, në konfliktin administrativ të paditëses, G.B. me vendbanim në P..., Lagja "... kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) me seli në Prishtinë, me bazë juridike: "*anulim vendimi*", në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqëse, me datë.15.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses G.B. me vendbanim në ..., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e saj si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) me numër A.nr.35/2023 me numër protokoli 1542/2023 i datës 07.02.2023, si i pa bazuar në ligj, ashtu që të njejtës ri njihet kompensimi, nga koeficienti 7 në koeficientin 8 që prej vitit 2014 deri më Janar të vitit 2024, si e pa bazuar.

II.Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në prani të palës paditëse personalisht dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur Atdhe Gashi me autorizim.

Paditësja G.B. me padinë e datës 21.03.2023 dhe në seancën mbi shqyrtimin kryesor ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesapadia e saj si e bazuar, ashtu që të anulohet vendimi kontestutes i të paditurit me numër A.nr.35/2023 me numër protokoli 1542/2023 i datës 07.02.2023, si i pa bazuar në ligj. Thekson se, të njejtës i është lëshuar akt emërimi i daës 01.04.2014 me koficent 7, nderkohe që kjo pozitë ka qenë me koeficientin 8, ashtu që sipas përshkrimit të detyrave të punës shihet që i ka kryer detyrat të

cilat lidhen me koficientin 8, andaj ka kërkuar nga gjykata që prej 2014 ti njihet kompensimi nga koficienti 7 në koficientin 8, deri në Janar të vitit 2024, pasi që pas kësaj datës është gjendje tjetër. Gjithashtu ka kërkuar që i padituri t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

I padituri KPMSHCK në përgjigjen në padi të datës 13.02.2024 dhe në seancën mbi shqyrtimin kryesor ka deklaruar që, mbetet në tërësi pranë vendimit të Këshillit dhe përgjigjes në padi, duke i propozuar gjykaëts që përmes këtij aktgjykimi të refuzojë padinë e paditëses si të pabazuar, ndërsa të vërtetojë ligjshmërinë e vendimit të Këshillit. Po ashtu gjykatës si provë materiale i ka dorëzuar dy aktgjykime, ku kjo gjykatë për çështje të njejtë, mirëpo për palë të ndryshme ka vendosur duke i refuzuar paditë si të pabazuara.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 15.10.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi dt.0302.2023 me nr.A.nr.35/23, regjistrimi i ankese dt.10.01.2023, ankesa dt.10.01.23, kërkesa për harmonizimi te koeficientit 16.11.22 me nr.prot.3150, kërkesa për harmonizimi 16.02.18, akt emërimi i dt.01.04.14, përshkrimi i detyrave te punës, emali i dt.23.01.23, kërkesa 16.01.23, aktgjykimi i dt 19.03.23 aktgjykimi 16.03.24 me nr 377/23.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit dhe deklarimin në seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës së kësaj çështje administrative, konstatoi se padia është e pabazuar.

Me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.35/2023 të datës 03.02.2023 është përfunduar procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.35/2023 e datës 10.01.2023 e parashtruar nga këtu paditësja

Paditësja e pakënaqur me këtë vendim, me datën 21.03.2023 ka ushtruar padi në këtë gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e këtij vendimi.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafi 1 dhe nën paragrafi 1.5 ku përcaktohet se: *“1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për*

pranim në shërbimin civil, 1. Kolegji i Këshillit që shqyrton ankesat, vendos në këtë mënyrë: 1.5. përfundimin e procedimit administrativ”.

Gjithashtu, duke iu referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 104 i cili përcakton se:” *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur ose i kotë”.*

Gjykata konstaton se, Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili me datë 05.01.2023 i cili me datën 05.02.2023, ka hy në fuqi. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës së të punësuarve në sektorin publik, duke përfshirë edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave, me të cilin përcaktohet se, gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohej çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficientëve aktual të pagave.

Andaj, gjykata konstaton se, duke marrë parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala paditëse kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, atëherë e paditura ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, për arsye se edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Gjithashtu, referuar periudhës kontestuese pra vitit 2014 kur edhe paditësja e ka marrë Akt emërimin e datës 01.04.2014 me koeficient 7, gjykata kishte parasysh nenin 130.1 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative ku përcaktohet se:” *Afati kohor për ankimin administrativ 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi. 130.2. Në rastin e mosveprimit të administratës (mos nxjerrjes së aktit dhe heshtjes së plotë), ankimi administrativ bëhet brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedimit administrativ”.*

Ndërsa me nenin 8.2 të Rregullores nr.05/2011 për Procedurën për Zgjidhjet e Kontesteve dhe të Ankesave, përcaktohet se, ankesa duhet të bëhet brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës.

Kështu, duke pasur parasysh shkresat e lëndës, gjykata gjen se, nga data kur paditësja ka marrë akt emërimin me koeficient 7, pra nga data 01.04.2014, e deri me datën kur e njëjta ka bërë kërkesën për

rregullimin e koeficientit, duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës, gjykata konstaton se paditësja i ka lëshuar afatet për realizimin e kërkesës së saj.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri, drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe të ligjit material, kur ka përfunduar procedimin administrativ të filluar sipas ankesës së datës 10.01.2023 të parashtruar nga paditësja

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditëses në padinë e tij, por ato nuk kishin ndikim, në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga organi i paditur. Mbi këto arsye, kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse gjykata vlerësoi se, nuk është zbatuar ligji në dëm të njëjtit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 616/2023 data 15.10.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Donjeta Nikolla

G j y q t a r e

Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.